



# NGJALLJA

Nr. 10 (153) Viti XIV i botimit

TETOR 2005

Çmimi 20 lekë

Manastiri i Shën Vlashit, Durrës

## Takim i klerikëve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë



Në fund të shtatorit në mjesditet e Manastirit të Shën Vlashit dhe të Akademisë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, në Durrës, u

zhvillua një takim i klerikëve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, ku morën pjesë edhe të gjithë anëtarët e Sinodit të She-

njtë, të kryesuar nga Fortlumturia i Tij, Kryepiskopi Anastas.

Kjo mbledhje i zhvilloi punimet nga data 19 deri 21 shtator dhe në të

u diskutuan shumë probleme që kleri i has gjatë kryerjes së shërbesave dhe në veprimtarinë e përditshme.

(Vijon në faqen 2)

**Promovohet libri “Ngjallja” - Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1991-2003”**

## Me dashuri të thellë për Zotin dhe shqiptarët

Ditën e martë, më 11 tetor 2005, ora 18:00 në Galerinë Kombëtare të Arteve, u promovua libri në anglisht “Resurrection” (“Ngjallja” - Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë 1991-2003), me autore misionaren amerikane Lynette Hoppe.

Libri, ka formën e një albumi me rreth 440 fotografi dhe ka në fokus Ngjalljen e Kishës Orthodhokse në Shqipëri.

Lynette Hoppe është diplomuar për Artet e Bukura në kolegjin e (Vijon në faqen 12)



## Takim i klerikëve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

(vijon nga faqja 1)

Ditën e parë, e hënë 19 shtator, në drekë, në manastir u mbledhën të gjithë pjesëmarrësit. Mbasdite u zhvillua edhe takimi i parë dhe përgatitja për Liturgjinë e së nesërme.

Fjalimin e parë e mbajti Kryepiskopi Anastas, rreth thënies të Apostullit Pavlit të shkëputur nga letra e dytë drejtuar Korinthisve (6,1) "Mos e lini të shkojë më kot hiri që pranuat nga Perëndia".

Kryepiskopi theksoi disa çështje si: Vlerësimi i hirit të dhënë nga Perëndia. Është një tragjedi ta lëmë të bjerë atë në zbrazëti, kur Perëndia na thirri dhe na dha Hirin e Tij. Gjithashtu, u theksua rëndësia e përmbushjes së misionit të klerikut, i cili duhet të jetë model imitimi dhe të jetë korrekt edhe në gjërat më të vogla. Ai duhet të jetë trasmetues i jetës së krishterë dhe i përjetimit të pastër dhe të sinqertë.

Gjithashtu, Kryepiskopi theksoi që kleriku duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme në jetën e tij shpirtërore. Kjo është një nga gjërat më të domosdoshme që duhet të ketë një klerik, sepse si do mundemi ne të ndihmojmë të tjerët shpirtërisht nëse nuk bëjmë përpjekje personale? Si do të ndriçojmë të tjerët kur nuk kemi vetë dritë?

Ditën e dytë, e martë 20 shtator, dita nisi me Liturgjinë Hyjnore, ku bashkëmeshuan hierarkë e klerikë nga të katër mitropolitë, dhe që u drejtua nga Kryepiskopi Anastas. Më pas u vazhdua me takimet e

radhës dhe temat e tyre. Një ndër temat kryesore ishte edhe ajo ekonomike. Folësit u ndalën në mangësitë e vërejtura dhe rrugët për kapërcimin e tyre. Gjithashtu u theksua, se edhe klerikët duhet të mendojnë edhe për veprimtari dhe burime nga brenda kishës që mund të mbulojnë shpenzimet, sepse vetëm kështu do mund të arrihet



autoqefalia ekonomike. E veçanta e mbasdites ishte ndarja e pjesëmarrësve në takim në tri grupe, të drejtura nga episkopët, në bazë të problematikave të caktuara, ku bënë edhe propozime konkrete për mbarëvajtjen e punëve.

Një fjalën e tij Hirësi Ignati, Mitropoliti i Beratit, në lidhje me misionin e klerikut përmendi faktin se ai duhet të predikojë Ungjillin dhe jo thjesht ta lexojë atë, por ta shprehë me gjithë forcën

e shpirtit të tij. Ky është çelësi i cili do të afrojë besimtarët në kishë. Ndërsa mosmarrëveshjet shkojnë në dëm të besimtarëve dhe i bëjnë të rinjtë të largohen nga kisha dhe të ndjekin rrugën larg saj dhe shpëtimit të Zotit tonë Jisu Krisht. Gjithashtu ai tha se: Një nga përgjegjësitë e klerikëve është që të nxisin dhe përgatisin kuadrot

klesh. Që nuk ka të bëjë thjesht me veten e tij po me një vizion akoma më të madh. Të gjitha vështirësitë, duhet ta bëjnë që të inkuadrohet më tepër në këtë luftë, si dhe të jetë pak më i ndërgjegjshëm në pozicionin e tij. Dhe të jetë i qartë se ç'po kryen.

Në mbledhje kishte diskutime të hapura nga klerikët në lidhje me jetën shpirtërore në famullitë e tyre, si dhe rreth problemeve dhe vështirësive që ata ndeshin në kryerjen e misionit të tyre. Pasi këto çështje u diskutuan u dhanë dhe udhëzimet e duhura dhe zgjidhje konkrete në kapërcimin e vështirësive dhe ushtrimin sa më të efektshëm të misionit të tyre.

E nesërmja, 21 shtator, ishte edhe dita e fundit e takimit, ku u rrahën edhe pikat e propozimit e dala nga grupet e veçanta, përpara se të gjithë të largoheshin për në enoritë e tyre.

Kryepiskopi Anastas mbylli atë duke i ftuar të gjithë pjesëmarrësit të psalin "Cila Perëndi është aq e madhe sa Perëndia ynë", lutje e cila do të na shoqërojë dhe do të na japë fuqi në përmbushjen e shërbimit tonë të shenjtë.

Përveç kohës dedikuar takimeve të programit, pjesë shumë e rëndësishme e ditës ishte kryerja e përbashkët e shërbesave, por edhe koha e lirë, që u jepte mundësi klerikëve të zonave të ndryshme të forconin miqësitë dhe të diskutonin rreth problemeve të dala etj.

Vlash Plepi

## Krijohet grupi i rinisë orthodhokse të Gramshit

Për herë të parë ngrihet grupi i rinisë orthodhokse edhe në qytetin e Gramshit. Prej tre muajsh po zhvillohen veprimtari shpirtërore e kulturore në njediset e kishës së Metamorfozës, e cila nisi të shërbejë më 6 gusht. Që prej asaj dite mbi 50 të rinj të qytetit mblidhen në mjediset e saj për të marrë pjesë në shërbesat e lutjes dhe aktivitetet e fundjavës. Çdo të shtunë, nën drejtimin e katekistëve bëhen mësimet me fëmijët dhe të rinjtë.

Pjesëmarrësit janë të interesuar për të dëgjuar fjalën e Perëndisë dhe dita-ditës numri i tyre po rritet. Aty zhvillohen edhe lojëra argëtuese e sportive me fëmijët dhe të rinjtë. Ndërsa dy të diela në muaj celebron Liturgjia Hyjnore.

Aktualisht është duke u punuar me plotësimin e ambienteve me bazë materiale, në mënyrë që të rinjtë të gjejnë të gjitha kushtet e nevojshme.

I.K.



Mitropolia e Gjirokastrës

## Vidhet dhe përdhoset manastiri i Derviçanit

Nëpërmjet protestës së bano-rëve të Derviçanit dhe nëpërmjet mediave u bë i njohur një sulm i ri ndaj një objekti të shenjtë orthodhoks. Natën midis 28 dhe 29 shtatorit, persona të "panjohur" kanë shpërthyer kishën e manastirit të Kryeengjellit Mihail, në Derviçan të Dropullit edhe e kanë përdhosur rëndë atë. Duket qartë se objekt i tyre nuk ka qenë thjesht grabitaja, por një urrejtje e dukshme.

Siç tregojnë besimtarët, pamja e kishës pas këtij vandalizmi ka qenë rrënoqthëse, me ikonat e shenjta të dëmtuara dhe të flakura ngado, me Tryezën e Shenjtë të dëmtuar dhe Hierroren si dhe të gjithë kishën të bërë rrëmujë. Sërisht autorët janë të paditur. Ka deklarata zyrtare se po punohet për kapjen e tyre, por ekziston ndjesia se do ndodhë e njëjta gjë si në vjedhjet e mëparshme. Seky manastir i shenjtë është vjedhur e dëmtuar dhe herë të tjera, por asnjëherë nuk është gjendur ndonjë autor.

Ndër vite në Mitropolinë e Gjirokastrës ka pasur dhjetëra e dhjetëra vjedhje kishash, përdhosje të tyre e deri madje është arritur sa t'u vihet zjarri dhe asnjë nga autorët nuk është gjetur ende. Vështirë se policia e zonës të ketë ndonjë zë tjetër krimesh me zbulueshmëri zero, si për aktet kundër vendeve orthodhokse të kultit, gjë që, më të paktën, dëshmon për mosdëshirë për t'i zbuluar autorët.

Ashtu siç është e çuditshme, që ndryshe nga zonat e tjera të Shqipërisë, në këto raste pothuajse nuk është ndjerë zëri i solidaritetit, duke hedhur hije mbi bashkëjetesën shembullore.

Kisha jonë dhe besimtarët asnjëherë nuk do heshtin për të dënuar këto akte dhe për të kërkuar drejtësi, por autoritetet duhet të ndërjegjësohen, se akte të tilla kanë backgraunde të dyshimta, të cilat duhen frenuar para se të japin fryte të hidhura për të gjithë shoqërinë.

## Pak histori

Manastiri ka vlera të veçanta historike, arkitekturore dhe artistike. Si kohë e ndërtimit të tij, duke u nisur nga tiparet e kompozimit të brendshëm dhe të formulimit arkitektonik të jashtëm, si dhe të teknikës dhe elementeve arkitektonike të përdorura, mendohet se manastiri datohet i shek. XVIII. Kisha është ndërtimi kryesor i manastirit dhe është e rrethuar nga të gjitha anët me ndërtime të karakterit dhe të kohëve të ndryshme, duke lënë rreth saj rrugica të ngushta, të shtruara me pllaka guri.

Manastiri ndodhet disi larg fshatit, në mal, është një vend shumë i nderuar nga besimtarët e zonës dhe më gjerë. Deri në mesin e vitetve '60 aty qëndronin dy motra, që kujdeshin për manastirin dhe flinin aty.



## PROTESTË

Ne banorët e enorisë "Fjetja e Hyjllindëses", Derviçan, shprehim protestën tonë të vendosur dhe dënojmë indiferentizmin e të gjithë përgjegjësve për ngjarjet që kanë ndodhur dhe ndodhin në manastirin e fshatit tonë, që i është kushtuar Kryeengjellit Mihail.

Të mërkurën, më 28/09/2005, muratorët nga fshati shkuan në manastir për vazhdimin e punimeve rregulluese dhe konstatuan se ishte bërë tentativë plaçkitjeje. Autorët ishin përpjekur të shpërthenin portën duke përdorur dhe mjete të tjera të rënda. Në vazh-

dim, pasi nuk patën sukses, hodhën një pjesë të murit, hoqën hekurat dopio të dritareve dhe u futën te katolikoni i manastirit.

Vodhën edhe pjesë të tjera nga ikonostasi, përdhosën ikonat e shenjta, të cilat i hodhën në dysheme. Gjithashtu, shkaktuan dëme në Tryezën e Shenjtë dhe në gjithë hieroren e kishës.

Këto ngjarje shkaktojnë indignatë dhe pikëllim. Provokim si nga ana e autorëve, ashtu dhe nga indiferentizmi i pushtetarëve, që të zbulojnë dhe të dënojnë rreptësisht autorët.

Ndërkohë që edhe autorët e vjedhjeve të mëdha të mëparshme, të majit dhe qershorit, janë ende të lirë, dhe ndoshta janë po të njëjtët persona që bënë edhe vjedhjen në fjalë.

Ne, me bindje të plotë në parimet e demokracisë dhe bashkekzistencës paqësore midis komuniteteve fetare, nuk mund të pranojmë më ofendime të tilla ndaj besimit të të parëve tanë.

Nuk kërkojmë shumë: duam të respektohen gjërat normale, të krijohen kushte sigurie, me qëllim që edhe të ruajmë ato që për

shekuj trashëgon Kisha jonë Orthodhokse, por edhe t'i zhvillojmë më tej.

Komuniteti ndërkombëtar dhe kryesisht Bashkimi Evropian, i cili ndihmon shumë në zhvillimin dhe përparimin e Shqipërisë le t'i kushtojë më tepër rëndësi çështjeve të tilla që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Nga banorët e enorisë së Derviçanit.

Derviçan, 29 shtator 2005

*Nis viti i ri shkollor në Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit"*

## "Të jeni të nxehtë në frymë duke punuar për Zotin"

Nisi viti i ri shkollor 2005-2006 në Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit", në Shën Vlash të Durrësit. Në datën 3 tetor, ditën e parë të vitit të ri akademik u mbledh komuniteti i pedagogëve dhe studentëve të Akademisë për të bërë shërbesën e Bekimit të ujit, e cila kryhet tradicionalisht në fillim të çdo viti shkollor. Kjo shërbesë u krye nga Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas dhe Drejtori i Akademisë, Episkop Ilia Ketri

Më parë studentët dhe pedagogët i kishin bërë një pritje të veçantë Kryepiskopit në hollin e Akademisë, duke e shoqëruar me himne kishtare për në kishën e shkollës, ku dhe u krye shërbesa e Ajazmës.

Në praninë e të gjithë studentëve, pedagogëve dhe stafit drejtues të shkollës Kryepiskopi Anastas dha mesazhin e forcimit dhe konsolidimit të këtij institucioni shumë të rëndësishëm për Kishën tonë.

"Ju keni bërë një zgjidhje të drejtë dhe nëse në një çast do të qëndroni në heshtje përballë vetë ikonës së Zotit, ndoshta do ta dëgjoni këtë zë, sepse vetë Zoti tha: "Nuk më keni zgjedhur ju mua, por unë ju kam zgjedhur juve". Askush nuk ka ardhur në këtë vend në mënyrë rastësore. Zoti ju ka folur në mënyrë të veçantë dhe në mënyrë të heshtur ju ka dhënë një lloj drejtimi në jetën tuaj", - tha në fillim të fjalës së tij Kryepiskopi Anastas.

Më tej, Kryepiskopi kërkoi nga studentët të vlerësojnë kushtet dhe rastin që Perëndia iu jep që hiri i Tij të lulëzojë dhe të japë fryte. "Në Akademinë Teologjike është bërë një përpjekje shumë e madhe për kushte sa më të mira në mënyrë që t'i ndihmojë studentët për të arritur rezultate sa më larta. Këtu kushtet i keni shumë të mira dhe nuk keni lodhjen e madhe për të bërë rrugëtime siç bëjnë studentët në vende të tjera. Ky është një rast që ju jepet dhe përpikuni që ta përdorni në një mënyrë sa më të drejtë. Këtë hir të madh që Perëndia ju jep, që të studioni, mos e lini të bjerë në të kot".

Kryepiskopi Anastas gjithashtu theksoi: "Është një rast që zemrat tuaja të çelen, të hapen që t'i ndriçojë dhe t'i shenjtërojë dhe që Shpirti i Shenjtë do t'i shndërojë. Bëni një përpjekje dhe një kujdes të veçantë. Duhet të kërkojmë hirin e Zotit që ta përdorim sa më mirë këtë rast që na jepet. Ne duhet të jetojmë në Krishtin. Pa hirin e Tij çdo gjë është e dobët dhe e varfër në vetvete. Nëse Ai e do, le t'i jepemi Atij me të gjithë qenien tonë".

Në fund të fjalës së tij, Kryepiskopi Anastas tha: "Uroj me gjithë zemër që ky vit akademik të jetë një vit krijues, që ju të përdorni drejt rastet që Perëndia ju fal: për një studim serioz, rast për të bërë një jetë shpirtërore akoma më të thellë, rast për të krijuar një familje të madhe të përbashkët, ku mbizotëron dashuria dhe respektimi i ndërsjellë. Unë jam i sigurt që hiri



pedagogë nga Greqia, Franca dhe SHBA për të dhënë leksione në akademi. Në të njëjtën kohë do të funksionojë edhe biblioteka, në mënyrë që studentët të thellojnë

Historia e kësaj shkollë nis më 7 shkurt 1992, kur Kryepiskopi Anastas hapi një seminar teologjik, që do të trajnonte të rinj dhe besimtarë vullnetarë për të mësuar shërbesat kishtare, duke i përgatitur që të shërbejnë në kisha, duke i dorëzuar dalëngadalë ata në klerikë. Klasa e parë me 45 studentë filloi studimet në një hotel, në plazhin e Durrësit, në kushte të vështira, me mungesa të ujit, energjisë e ngrohjes.

Në vitin 1996, shkolla u zhvendos në një kompleks modern ndërtesash të reja pranë Manastirit të Shën Vlashit, në fshatin me të njëjtin emër, në Durrës.

Kryepiskopi Anastas e zgjeroi fokusin e shkollës nga një seminar i drejtuar vetëm për përgatitjen e klerit, në një Akademi Teologjike për djem dhe vajza. Në vitin 1997 filluan të përgatiten dhe të studiojnë edhe vajza që do të shërbenin në veprimtaritë e ndryshme të Kishës. Deri tani në Akademinë Teologjike janë diplomuar rreth 200 studentë. Nga këta të diplomuar 130 prej tyre janë bërë klerikë dhe shumë të tjerë shërbejnë në aktivitete të ndryshme të Kishës.

Qëllimi i Akademisë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" është të sigurojë formimin shpirtëror dhe akademik të klerit të ri dhe besimtarëve shqiptarë nëpërmjet studimeve teologjike, përjetimit liturgjik dhe jetës në komunitet.

*Isidor Koti*

*Deri tani në Akademinë Teologjike janë diplomuar rreth 200 studentë. Nga këta të diplomuar 130 prej tyre janë bërë klerikë dhe shumë të tjerë shërbejnë në aktivitete të ndryshme të Kishës.*

i Perëndisë do të mbushë të gjitha ato boshllëqe që ne ende kemi dhe të na japë të gjithëve dritën dhe shkëlqimin e Shpirtit të Shenjtë".

Këtë vit shkollor, sipas drejtorit të Akademisë, Imzot Ilia Ketri do të vazhdojë të pasurohet edhe më tej cilësia e mësimdhënies në mënyrë që studentët të marrin një formim të mirëfillt teologjik. Gjithashtu edhe këtë vit pritet të vijë

njohuritë në fusha të ndryshme. Studentët do të kenë mundësi të marrin njohuri të reja edhe në dy lëndë të tjera: Psikologji dhe Komunikim-informatikë. "Nga pikëpamja shpirtërore ne do të vazhdojmë përjetimet e shërbesave në adhurimin e Zotit çdo ditë, duke forcuar kështu jetën spirituale të studentëve", - tha për gazetën Imzot Ilia.



*Në fotot: Çast nga shërbesa e ajazmës në kishën e Akademisë Teologjike "Ngjallja e Krishtit"*

## Hapi dyert shkolla e re fillore “Frymë Dashurie”, në Durrës

Në qytetin e Durrësit sivjet hapi dyert një institucion i ri arsimor i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, shkolla fillore “Frymë Dashurie”. Pas shkollës shqiptaro-amerikane “Protagonistët”, kjo shkollë, shqiptaro-greke, është institucioni i dytë i këtij lloji që hapet nën kujdesin dhe me mundësitë e krijuara nga Kryepiskopi Anastas.

Shkolla, me sistemin e ri 9-vjeçar, me një staf tme kualifikim të lartë, do përdorë metoda bashkëkohore dhe të tilla do këtë edhe pajisjet dhe mjediset. Sivjet filloi mësimi me një klasë të parë dhe në foto paraqiten çaste nga dita e parë e saj.

*Foto nga dita e parë e mësimi.*



## Përkujtohen viktimat e uraganit “Katrina”

Më 8 shtator, në kishën “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, në Tiranë u zhvillua një Liturgji Hyjnore, e cila u celebrua nga Imzot Ilia, i ndihmuar nga Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë, Protopresviter Jani Trebicka e shumë klerikë të tjerë.

Në predikimin e tij Imzot Ilia theksoi rëndësinë që ka Lindja e Hyjlindëses, nëna e Zotit tonë Jisu Krisht, e cila është e kremtja e parë, e Vitit të Ri kishtar që filloi më 1 shtator.

Imzot Ilia, duke kujtuar viktimat e uraganit “Katrina” shprehu keqardhjen për këtë fatkeqësi që mori jetë njerëzish dhe shkaktoi dëme të mëdha, dhe me këtë rast shprehu edhe ngushëllimet e të gjithë besimtarëve orthodhoksë.

Gjithashtu, Imzot Ilia solli dhe përshëndetjet nga shqiptarët e Amerikës të cilët gëzohen për sukseset që janë arritur në kishat e Shqipërisë.

*Kostandin Bozaxhiu*

## Fillon viti i ri shkollor edhe për shkollën “Protagonistët”

Viti shkollor 2005-2006 e gjen shkollën fillore Shqiptaro-Amerikane “Protagonistët” me 102 nxënës dhe me një staf prej 17 mësuesish të gjithë me arsim të lartë.

Puna e mirë dhe e kualifikuar e stafit duket në kontigjentin e nxënësve çdo vit, i cili jo vetëm nuk ndryshon po rritet. Kjo na kënaq dhe na vë para përgjegjësi me të

mëdha për të ardhmen. Mësuesit ndjekin me kujdes çdo ndryshim në metoda dhe trajnohen nga drejtoresha Shannon Sakellariu me materiale bashkëkohore në perfeksio-

nimin e mësimdhënies, duke e ndërthurur atë me metodën e përparuar amerikane.

*Korresp. i “Ngjallja”*

*Foto nga dita e parë e mësimi.*



## Debat shkencor për Onufrin

# NIKOLLA, BIR I ONUFRIT DHE JO I ONUFËR QIPRIOTIT

(vijon nga numri i kaluar)

Në artikullin e tij, z. Hasan Nallbani, ka gabuar në leximin e dy datimeve, në atë të “Dyerve të Bukura”, të ikonostasit të kishës “Shën Mari Vllaherna”, në kalanë e Beratit e shkruajtur (A F g A), d.m.th. vitin 1591 e lexon 1569, si dhe mbishkrimin e kishës “Shën Kolli” pranë Vllahernës të shkruajtur po prej Qipriotit (A F g A), d.m.th. 1591 e lexon po gabim 1609. Që të dy datimet 1569 dhe 1609 të pretenduara prej tij, sipas referimit të alfabetit të greqishtes së vjetër, duhet të ishin shkruar, e para (A F e q), ndërsa e dyta (A, X, q).

Datimin e parë e ka çuar 22 vjet më përpara dhe të dytën 18 vjet më vonë, kur ato janë realizuar që të dyja në vitin 1591. Ky mbishkrim i tij e ka çuar atë në konsiderata dhe mendime të gabuara mbi ngjashmërinë stilistike ndërmjet tri ikonografëve.

Në kapitullin e parafundit autori shkruan: “Në pikturën murale të kishave të Shelcanit, të Valshit dhe në atë të Shën Todrit, në kalanë e Beratit, nuk gjejmë elemente ikonografike dhe dekorative që të na kujtojnë pikturën e Nikollës të “Konstandini dhe Helena” të pikturuar nga Qiprioti”.

Meqë jemi pranë këtyre konkluzioneve, do të mundohem të paraqes argumente që i kundërshtojnë ato. Është e njëjta figurë e arkangjelit që ndodhet në krahun e majtë të Shën Marisë Platitera. Po të vëmë re me kujdes, kemi të njëjtën paraqitje të figurës. Konstatohet të njëjtën lëvizje apo plastikë të përkuljes së trupit. Koka e arkangjelit, e siluetuar brenda aureolës, është e njëjta, po kështu lëvizjet e krahëve të tyre si dhe të vendosjeve të flatrave njëra poshtë dhe tjetra e ngritur lart, e duke krijuar pranë aureolës një hapësirë të njëjtë, gjithashtu dhe dekori me pika që gjendet në veshjet e tyre.

Tani le të marrim rastin e dytë, Baldakinin, e realizuar nga Qiprioti për kishën “Konstandini dhe Helena” dhe atë të Nikollës, që realizoi për kishën “Shën Mari Vllaherna”. Që në pamje të parë kemi të bëjmë me një ndryshim në një paraqitje të një numri të madh shenjtorësh. Te ai i Qipriotit, dhjetë në një krah dhe dhjetë në krahun tjetër, dhe secili krah që fillon nga skena “Deissis”, ndodhet figura e arkangjelit, ndërsa tek Nikolla janë dhjetë gjithsej, pesë e nga pesë për çdo krah, gjë të cilën e shohim te baldakini i Onufrit, të realizuar për kishën e Evangjelizmoit në kalanë e Beratit. Tek Onufri dhe te Nikolla, shenjtorët janë të

radhitur njësoj, tipat afrohen më shumë me njëri-tjetrin, bile mbajtja e librave të shenjtë dhe pergamenëve është pothuajse e njëjtë, ndërsa tek Qiprioti është tjetër gjë. Për ta ilustruar mund të paraqesim ndërtimin arkitekturor në mënyrë skematike, ku janë paraqitur

*Këto argumente që paraqitëm këtu, nëpërmjet shembujve, tregojnë se Nikolla ka qenë pranë Onufrit, babait të tij dhe jo më kot ai shkruan në mbishkrimin e kishës së Vllahernës: “... unë Nikolla, bir i Onufrit,...” jo i Onufër Qipriotit, por i mjeshtrit të madh Onufri.*



dhe dekori lulëzor. Një ndryshim të madh me Qipriotin dhe ngjasim me Onufrin, për Nikollën e shohim në trajtimin apo zbukurimin e aureolave të shenjtorëve. Ikonat e Nikollës dhe të Onufrit kanë ngjashmëri të theksuar, ku loja e zbukurimit bëhet nëpërmjet pikave të realizuara me majën e një bulinoje metalike mbi shtresën e arit, ndërsa tek Qiprioti, aureolat janë të trajtuara me pika shumë të imëta e të cekëta. Ndërsa te figurat kryesore, si Krishti dhe te Shën Maria, Joan Pagëzori, Shën Theologu etj., Qiprioti aplikon teknikën e stukotelievit, duke

realizuar motive bimësh e degësh. Përsa i takon kaligrafisë së shkrimit të tre ikonografët, shohim përsëri elementë të ngjashëm që afrojnë Nikollën me Onufrin. Këtu kemi marrë në analizë gërmat E, O, F d, B. Duke filluar nga gërma E, shohim që Qiprioti ndryshon nga ajo e Onufrit dhe e Nikollës. Fundi i gërmave “E” është i harkuar, ndërsa tek Onufri dhe Nikolla përfundon me majë.

Kjo ndodh gjithashtu te rasti i gërmave O, P, F, d dhe B, tek shkrimet e librave të shenjtë që mban në dorë Krishti, si dhe tek gërma e parë e fillimit të tekstit në këtë libër. Nikolla së bashku me Onufrin vendosin rreth e qark siluetit të gërmës “E” gjethe të vogla, ndërsa Qiprioti siluetin e lë të lirë. Po kështu, raste të ngjashme midis Nikollës dhe Onufrit, shohim edhe te mënyra e mbajtjes së librit të shenjtë nga Krishti, ku Qiprioti i ka vendosur në drejtim të kundërt me atë të Nikollës dhe të Onufrit.

Një nga shembujt e fundit që do të paraqes, është modelimi dhe plastika në realizimin e portreteve të Krishti Pantokrator. Ato të Nikollës e aq më tepër tek ato të Onufrit, i përkasin modeleve dramatike ku, nëpërmjet vizatimit të theksuar të tipareve dhe aksentimeve me dritën e fortë pranë bebëzave të syve provokojnë tension. Ndërsa te Qiprioti, karakterizohen nga tonet e ngrohta të okrave. Vizatimi linear i tipareve dhe i formave është më plastik te portretet e pikturuara prej tij. Ai fillon nga pikturimi mbi ngjyrën kafe të ngrohtë ndryshe nga Nikolla dhe Onufri, të cilët procedojnë në mënyrë të rregullt sipas kanuneve të stilit bizantin, ku vendet e dritave maksimale që burojnë nga poshtë syve në drejtim të mollëzave, duke e bërë në mënyrë tepër kaligrafike me anë të përdorimit të vijave të bardha e tepër të holla, dy e nga dy të barazlanguara nga njëra-tjetra. Qiprioti nuk e bën një gjë të tillë. Vendosja e dritave, si dhe modelimi me anë të toneve të së bardhës, është shumë i lirshëm në dhënien e volumeve dhe të formave, e cila afron apo ngjason me portretet e realizuara nga piktorët e Rilindjes italiane.

Këto argumente që paraqitëm këtu, nëpërmjet shembujve, tregojnë se Nikolla ka qenë pranë Onufrit, babait të tij dhe jo më kot ai shkruan në mbishkrimin e kishës së Vllahernës: “... unë Nikolla, bir i Onufrit,...” jo i Onufër Qipriotit, por i mjeshtrit të madh Onufri.

*Mustafa Arapi, piktor, restaurator*

Kontribut i rëndësishëm i Kishës për shëndetin


## SKANERI I RI I QENDRËS DIAGNOSTIKE “UNGJILLËZIMI” - - I DYTI NË BALLKAN

Kontributi për shëndetin e popullatës i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe personalisht i Kryepiskopit Anastas ka qenë i ndjeshëm gjatë gjithë viteve të demokracisë. Ai është shprehur si nëpërmjet donacioneve e ndihmave të konsiderueshme, në kohë të qeta e krizash, si për shembull me ilaçet dhe pajisjet e dhuruara për spitalet, refugjatët, të përmbyturit, individët në nevojë, shërbimi ambulator dentar falas për mijëra fëmijë e të rritur etj., etj., ashtu edhe nëpërmjet qendrave moderne diagnostike, veçanërisht asaj të kryeqytetit.

Qendra Diagnostike “Ungjillëzimi”, pret çdo muaj mijëra pacientë, të cilët i tërheq shërbimi i kualifikuar dhe i kulturuar, por në radhë të parë, fakti se në duart e mjekëve që punojnë aty janë vënë aparatet nga më modernet jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë rajonin tonë.

Për Kryepiskopin Anastas, sigurimi i një skaneri cilësor për qendrën ka qenë prej vitesh një objektivi primar. Por kostoja e lartë dhe

**Skaneri i blerë për Qendrën Diagnostike është prodhim i kompanisë amerikane General Electric, Light Speed Pro32.**



synimi për të pasur një aparat sa më bashkëkohor e bënë të vështirë realizimin e kësaj ëndrre, që tashmë e shohim të konkretizuar në maksimumin e saj.

Skaneri i blerë është prodhim i kompanisë amerikane General Electric, Light Speed Pro32.

Skaneri (ose Tomografi e kompjuterizuar), është i tipit spiral, multidetektor, me 32 prerje në një rrotullim dhe është një hap i ndjeshëm përpara edhe në raport me skanerat e mëparshëm multidetektor. Ai karakterizohet nga një shpejtësi tepër e lartë e ekzaminimit, sidomos krahasuar me aparatet që janë në

përdorim në vendin tonë, gjë që e bënë të përshtatshëm jo vetëm për ekzaminimet konvencionale, por edhe të atyre të enëve të gjakut. Gjithashtu, janë përmirësuar ndjeshëm edhe mundësitë për kontrollin e mushkërive, traumave, në pediatri etj.

Sipas të dhënave, ai është skaneri i vetëm i këtij lloji në gjithë Evropën Juglindore (përfshirë edhe Greqinë, ndërsa vetëm në Lubjanë është një aparat më i fuqishëm). Kështu, imazhi i organeve statike mund të krijohet nga aparati vetëm në dy sekonda, një kalim i përgjithshëm, për të gjithë gjatë-

sinë e trupit mund të bëhet duke e mbajtur vetëm një herë frymën, dhe një skanim i zemrës mund të kryhet në 10-12 sekonda. Ky skaner mund të arrijë rezolucione të larta figure me doza të ulëta rrezatimi, si dhe mund të krijohen imazhe 3-dimensionale.

Siç thamë, në krahasim me skanerat spiralë me një detector, që operojnë aktualisht në Shqipëri (vetëm në sistemin publik ka një skaner të vetëm multidetektor), është në gjendje që të japë të dhëna me një cilësi tepër më të lartë, por njëkohësisht, shpejtësia me të cilën kryen ekzaminimin e bënë shumë të për-

*Ai karakterizohet nga një shpejtësi tepër e lartë e ekzaminimit, sidomos krahasuar me aparatet që janë në përdorim në vendin tonë, gjë që e bënë të përshtatshëm jo vetëm për ekzaminimet konvencionale, por edhe të atyre të enëve të gjakut. Gjithashtu janë përmirësuar ndjeshëm edhe mundësitë për kontrollin e mushkërive, traumave, në pediatri etj.*

shtatshëm për sëmurët rëndë ose moshat e mëdha, të cilët nuk mund të përballonin një ekzaminim të zgjatur.

Një tjetër e veçantë e këtij skaneri (që nuk mund të bëhet me aparatet e deritanishme) është mundësia e realizimit të koronarografisë diagnostike, që deri tani kryhet vetëm me koronarografinë konvencionale, duke ulur ndjeshëm rreziqet e këtij diagnostikimi.

Skaneri do të përdoret nga një personel me kualifikim të posaçëm, të realizuar jashtë vendit.

*Korresp. i “Ngjallja”*

## Shërbimet që ofron Klinika Orthodhokse Diagnostike “Ungjillëzimi”

Themelet e kësaj qendre u hodhën në gusht të vitit 1997, me nisim dhe fondet e mbledhura nga Kryepiskopi, Prof. Dr. Anastasi. Dy vjet më vonë klinika u shenjtërua dhe u përrua nga Patriku Ekuimenik, Vartholomeu I, në nëntor të vitit 1999 gjatë vizitës së Tij në vendin tonë. Që nga dita e çeljes e deri më sot, ajo vazhdon të jetë ndër më bashkëkohoret dhe më konkureset me simotrat e saj në vend dhe në rajon.

Gjithkush që paraqitet në këtë klinikë gjen një mjedis të ngrohtë, me punonjës të kualifikuar e shërbim cilësor. Ky shërbim i ofrohet të gjithë njerëzve pa dallim besimi. Të ardhurat shkojnë për mirëmbajtjen, funksionimin, rinovimin me pajisje të reja, siç qe blerja së fundi e skanerit. Klinika është një nga më modernet në Shqipëri e në të ekzistojnë kabinete të ndryshme, që u vijnë në ndihmë mijëra pacientëve:

### Kabineti i Ekografisë

Funksionon me volum të plotë pune që në ditët e para të hapjes së klinikës. Teknologjia e përparuar bënë të mundur realizimin e një game të gjerë ekzaminimesh, të cilat kryhen me aparatet ekografike, prodhim i vitit 2001. Mundësia e lidhjes me rrjetin e ekografisë (Ultrasound network), me qendër në Athinë, bënë të mundur realizimin e bashkëpunimit nëpërmjet internetit me kolegë në vende të

ndryshme të Evropës, për të zgjidhur problematikën e rasteve të vështira.

### Kabineti i Fizioterapisë

Në këtë kabinet gjithçka bëhet me aparatet moderne si: lazer terapi, ultratinguj, tens, mikroval terapi etj. Këtu trajtohet me sukses edhe mjekimi me rreze lazer për të gjitha problemet neurologjike.

*(Vijon në faqen 8)*

## Shërbimet që ofron Klinika Orthodhokse Diagnostike “Ungjillëzimi”

### Kabineti i Grafisë

Në kabinetin e Imazherisë, ku janë instaluar dy aparate moderne të radiologjisë konvencionale realizohet e gjithë gama e ekzaminimeve që përmbledh kjo fushë. Këto ekzaminime përfshijnë ato të sistemit kockor, aspirator, kardiovaskular, të aparatit tretës, urinar etj. Është një nga kabinetet më të kompletuar që funksionojnë në vendin tonë. E veçanta e këtyre aparateve është doza minimale e rrezatimit dhe cilësia e lartë e imazhit që përftohet. Me anë të këtyre aparateve mund të bëhet ekzaminimi i hershëm dhe si rezultat, trajtimi më i hershëm i një sërë patologjish. Në këtë kabinet ekziston edhe aparati i mamografisë, i cili zbulon sëmundjet e gjirit dhe nëpërmjet saj bëhet profilaksia e sëmundjeve të gjirit.

### Kabineti i Kardiologjisë

Përveç një vizite nga mjekët me përvojë, pacientëve u ofrohen edhe shërbime të tjera si: Ekografi, Elektrokardiografi, Eko Ezofagiale dhe Holteri, që është një aparat që bën regjistrimin e kontrollit të ritmit të zemrës gjatë 24 orëve. Përveç holterit të ritmit u vendos edhe holteri i tensionit, i cili regjistron tensionin gjatë 24 orëve. Biçikleta ose tapeti lëvizës favorizon moshën të ndryshme ta kryejnë atë.

### Kabineti i Kirurgjisë

Që nga viti 2001 ka filluar punën kirurgjia ambulatore nën përgjegjësinë e kirurgut amerikan, Charls Linderman. Një sallë operacioni, e pajisur me aparate të teknologjisë së fundit, me një sterilizim maksimal si në vegla ashtu edhe në ambientin rrethues, me shtratin e operacionit, llambën ndriçuese, instrumentet dhe sterilizatorin, elektrobisturinë.

### Kabineti i Neurologjisë

Kabineti i Neurologjisë, i cili drejtohet nga mjekë me përvojë, është i pajisur me aparatura nga më modernet të kohës, të cilat ofrojnë mundësinë e kryerjes së ekzaminimit të EEG dhe EMG. Të sëmurët u nënshtrohen këtyre aparaturave pasi kanë bërë vizitat nga mjeku specialist neurolog. E reja e këtyre aparaturave është se në aparatit e EEG punohet në 32 kanale, gjë e cila nuk është kryer deri më sot në Shqipëri, dhe kemi një hartë të trurit, e cila mund të shumëfishohet dhe të tregojë më qartë vendin ku është patologjia, d. m. th. tregon me saktësi anën funksionale të dëmtimit të trurit. Kurse, në aparatit e EMG kryhen ekzaminime të rëndësishme si: matja e përçueshmërisë së sistemit nervor periferik, ajo motore apo sensitive, si dhe përcaktohen diagnoza të rëndësishme që

kanë të bëjnë me patologjinë e sistemit nervor periferik.

### Kabineti i Obsetrikës dhe Gjinekologjisë

Shërbimi i obsetri-gjinekologjisë kryen ekzaminime cilësore, si për sëmundjet gjinekologjike ashtu edhe për ndjekjen e shtatzënisë, zhvillimin e efekteve të fëmija i ardhshëm. Për këtë janë të gjitha kushtet të plotësuara edhe me shërbimin ekografik njëkohësisht me aparatura që janë në gjendje të kontrollojnë rrahjet e zemrës së bebes etj.

### Kabineti i Pediatriës

Fëmijëve u kushtohet një vëmendje e veçantë, që nga i porsalinduri e deri në moshën e adoleshencës, përfshi edhe çështjen e mirërritjes së tyre. Brenda këtij kabineti trajtohen edhe probleme të specialiteteve të pediatriës si: pneumatologjisë, gastro-enterologjisë, kardiologjisë së fëmijëve, psikopediatriës etj.

### Laboratori Klinik-Biokimik

Në këtë laborator përdoret teknologjia bashkëkohore e kimisë klinike për realizimin e një game shumë të gjerë të analizave kliniko-biokimike. Kjo teknologji është bazuar në përdorimin e aparaturave automatike dhe gjysmë automa-

tike të kontrolluara me programin bashkëkohor të kontrollit.

### Laboratori Mikro-Biologjik

Pajisje cilësore si: mikroskopi me zmadhim të madh, teste të shpejta dhe cilësore siç është lateksi, aparatura që lejon diagnostikimin bazuar në floreshencën si edhe aparati i elektroforezës, që janë nga më të fundit, janë instaluar në këtë klinikë. Në laboratorin mikro-biologjik kryhen ekzaminime bakterologjike kryesisht për diagnozën e infeksioneve të ndryshme si ato të aparatit respirator, urogenital, gastrointestinal etj.

### Laboratori Dentar

Ky laborator është i pajisur me aparatura të automatizuara, të kohëve të fundit dhe me një personel të kualifikuar. Krahas diagnostikimit kryhet edhe mjekimi i të gjitha gradave të sëmundjeve të dhëmbëve. Gjithashtu kryhen punime në ura porcelani, proteza të skeletuara të kromkobaltit dhe proteza parciales dhe totale të rezinës.

Gjithashtu në klinikë funksionon edhe kabineti i Morfologjisë, i cili është një ndër sektorët më të kualifikuar. Ofrohen edhe shërbime të tjera si ai i onkologjisë, patologjisë, endokrinologji, ORL, reumatologji, okulistikë, dermatologji, nefrologji, dhe urologji.

## Nga bota e Krishterë

### Jerusalem

#### Caktohet Patriku i ri

Arqipiskopi Theofil i Malit Tavor u zgjodh si Patriku i ri i Jerusalemit. Ceremonia u zhvillua në kishën e “Ngjalljes”. Ai është 53 vjeç dhe shihet si një kandidat që mbledh konsensus dhe paqtes, pas problemeve që kaloi selia kohët e fundit. Ai mori menjëherë urimet e të gjithë kryetarëve të kishave orthodhokse, si dhe pranimin nga shteti jordanez dhe autoriteti palestinez dhe është në pritje të miratimit nga shteti izraelit.

### Greqi

#### Presidenti Putin vizitoi Malin e Shenjtë

Presidenti rus, më 9 shtator vizitoi Athosin, Malin e Shenjtë. Vizita u paraqit nga personat përgjegjës, si “pelegrinazh i natyrës private”. Presidenti Putin shkoi në qendrën administrative të Karies-it, ku u takua me drejtues të komunitetit monastik dhe më pas vizitoi manastiret e Ivronit dhe të Shën Pandelejmonit (shumica e 60 murgjve të të cilit janë me origjinë ruse ose ukrainase). Kjo ishte vizita e parë e një udhëheqësi rus në këtë vend të shenjtë.

### Turqi

#### Protestë për cënimin e pronave

Ndërsa u çelën negociatat midis Bashkimit Evropian dhe Turqisë, Patrikana Ekumenike denoncon presionet administrative mbi të. Kështu, Patriku Ekumenik ka protestuar energjikisht për faktin që prona të Kishës Orthodhokse janë regjistruar si “prona shtetërore”. Rasti i fundit i këtillë ishte ai i regjistrimit si prona shtetërore të manastireve orthodhokse të arqipelagut të Princërve, në detin Marmara. Ndërkohë, nuk duhet harruar se në skenën ndërkombe, Patriku Ekumenik Vartholomeu I ka mbështetur me vendosmëri pranimin e Turqisë në BE.



Patriku Ekumenik Vartholomeu I me Kryetarin e BE Barroso



Gjithmonë e më shpesh bizneset, të mëdha apo të vogla, e nisin veprimtarinë e tyre duke kërkuar së pari bekimin e Perëndisë. Në fotot: Kryepiskopi Anastas gjatë ajzmës për përrurimin e filialit të BMW-së në vendin tonë.

## Viktori Puzanova, bizantologia ruse që studioi artin bizantin në Shqipëri

*Nga Maks Velo*

Mbas tre shekujsh të rritjes së fuqisë osmane (16,17,18) në shekullin e 19-të, duken shenjat e para të dekadencës së perandorisë.

Atëherë fillojnë dhe vizitat, shërbimet, ekspeditat dhe udhëtimet e një numri të madh diplomatësh, ushtarakësh, shkencëtarësh, artistësh, shkrimtarësh dhe vagabondësh nga të cilët botohen në Evropë raporte, ditare, shkrime, vizatime<sup>1</sup>.

Ato rrahin një sërë problemesh administrative, gjuhësore, historike, folklorike, arkitektonike, arkeologjike, gjeologjike, tregtare, të florës dhe të faunës dhe të meteoreologjisë.

Të gjithë këta janë evropianë. Për herë të parë Shqipëria po studiohet.

Perandoria Islamike Osmane nuk ish e zonja të studionte veten e vet dhe si rrjedhim, as shtetet që kish nën sundim.

Me sa duket interesimi i kancelerive, shoqatave shkencore dhe industriale, personave privatë rritet edhe për vendet ballkanike që kanë fituar pavarësinë ose jo, në pritje të zhvillimeve të reja. Dhe për më tepër, sepse Shqipëria një nga vendet e para ku u përhap krishterimi, po vuante akoma sundimin osman, që e kish detyruar pjesën më të madhe të popullsisë të konvertohej në myslimane.

Po asnjëri nga këta shkencëtarë nuk analizon artin bizantin. Ka vetëm informacione<sup>2</sup>.

Ky shekull, i 19-ti, ka burime dhe informacione të shumta, që sot ndihmojnë shkencat albanologjike si lëndë e parë e pagmuar arkivore.

Kuptohet që festimet e bujshme me fishekzjarre dhe ballo në gjithë kryeqytetet evropiane, për ardhjen e shekullit të ri, të XX-të, u ndjenë edhe në Shqipëri.

Perandoria Osmane po shkërmoqej.

Shekulli i XX-të ish për vendin tonë me shumë evenimente të njëpasnjëshme që nga shpallja e pavarësisë më 1912, pastaj me formimin e një republike parlamentare, bekimin e mbretërisë, pushtimin fashist, diktaturën komuniste dhe së fundi demokracinë problematike.

Në kërkimin e identitetit kombëtar kemi disa pika referimi dhe vlera të padiskutushme dhe një bosht: Shqipëria si një vend i krishterë që në antikitet.

Mbas kësaj jemi kapur fort, për të rigjetur rrënjët në histori, për të forcuar vullnetin tonë, për të bindur Evropën ku duam të shkojmë.

Si provë të kësaj sjellim objektet e artit bizantin.

Objektet e kultit kristian janë ato që ruajnë vlerat më të mëdha artistike dhe historike. Të tilla janë kodikët e shek. të 6-të dhe të 9-të të Beratit (në Arkivin e Shtetit ruhen mbi 100 kodikë), epitafi i Gllavenicës, me qindra ikona të mreku-

llushme dhe me mijëra metër katrore me afreske.

Arti bizantin është banga jonë e provës materiale e trashëgimisë kristiane. Pjesën artistike të ikonave dhe afreskeve e zbuloi dhe e studioi Viktori Puzanova.

Ajo gjatë gjithë kohës pati mbështetjen dhe ndihmën e Theofan Popës, i cili i deshifroi mbishkrimet bizantine dhe si një martir i vërtetë i krishterimit shpëtoi gjatë periudhës 1967-1973 me qindra ikona, që sot ruhen në muzeumet tona.

Duhet të vinte gjysma e dytë e shekullit të njëzetë, që kjo albanologe e madhe të bënte zbulimet më të rëndësishme në artin tonë.

Puzanova ish një personalitet vërtetë i rrallë dhe i papërsëritshëm.

Ajo kish të bashkuar në një dijet dhe intuitën e shkencëtares me ndjeshmërinë dhe sensibilitetin e një artisteje.

Mbi të gjitha ajo kish frymën e sakrificës dhe devotshmërinë e një Zonje të rrallë, e cila diti që tërë talentin dhe vullnetin e saj ta vërë në shërbimin e një misioni të lartë, pa kërkuar asgjë në këmbim.

Ajo arriti të zbulojë dhe të vlerësojë, të studiojë dhe komentojë një art të madh, të panjohur e të pazbuluar; produkt i qindra mjeshtrave dhe artistëve të përrulur dhe modestë, që në kushtet më të rënda të kohës, në periudhën më të errët të islamizimit të vendit me dhunë, vazhduan të mbajnë lart frymën e

shenjtë të krishterimit të njërit prej popujve më të vjetër të Ballkanit.

Ky art i madh i krijuar para dhe mbas pushtimit osman, është sot dëshmia e rezistencës historike dhe artistike, e një patriotizmi të pabujë, e një sakrifice sublime që vazhdoi disa shekuj.

Dhe këtë afresk të madh gjigant në murin e madh të historisë sonë, ish pikërisht Zonja e madhe Viktori Puzanova që e pa e para, njohu vlerat e tij dhe e çmoi lart.

Për këtë, kombi ynë i është pafundësisht mirënjohës.

Ajo qëndroi këtu në periudhën më të errët të diktaturës me privacionet e paimagjinueshme, njëlloj si piktorët asketë që punuan nëpër kishat e vogla të fshatrave shqiptare.

Ajo pa dyshim është dekane e Bizantologjisë Shqiptare.

Asnjë studiues tjetër i artit bizantin në Shqipëri nuk ka atë shkëlqim të butë dhe kjo rrjedh nga kultura e saj dhe dashuria për njerëzit.

Puzanova, si asketët ose si murgeshat, rronte e tëra për artin dhe për shkencën.

Ajo kish dhuntinë e rrallë të sakrifikimit sublim pa kërkuar asgjë.

Ish një fat i madh për ne që ajo erdhi në Shqipëri.

Kështu të rastësishme janë nganjëherë prurjet më të rëndësishme, që nuk jemi në gjendje t'i vlerësojmë si duhet në momentin e shfaqjes, se janë aq të pastra, të druajtura dhe të heshtura.

*(vijon në faqen 10)*

## Viktori Puzanova, bizantologia ruse që studioi artin bizantin në Shqipëri

(vijon nga faja 9)

Vepra e zonjës Puzanova është akti më sublim i qytetares, shkencëtares, artistes dhe i së krishterës që vinte nga Rusia e largët.

Ajo solli dhe la një frymë tjetër nga fryma bolshevike leniniste.

Ajo ish për mua mishërimi më i denjë i shpirtit të madh kristian rus.

Ajo ish krenare për këtë, dhe e konfirmoi me jetën e saj.

Pa këtë frymë, pa atë ndërgjegje, ajo nuk do të kish mundur të realizonte misionin e saj të vështirë.

Viktori Puzanova ka lindur në vitin 1893 në qytetin Rostov të Rusisë. Qe nga një familje aristokrate. Studioi në Fakultetin e Artit në Shën Peterburg në degën e skulpturës. Deri në vitin 1917 jetoi në Rusi.

Pas Revolucionit të Tetorit në moshën 24 vjeç u largua përgjithmonë nga Rusia, ku nuk pati mundësi të kthehet kurrë.

Burri i saj, Vasil Puzanov, kish qenë oficer i Carit.

Mbasi vizitojnë Francën, Italinë, qëndrojnë në Beograd, ku Viktoria punon në Muzeun e Artit. Qendra e punës së saj ishin manastiret në Kosovë.

Në Kosovë takon Rrok Zojzin, arsimtar, i cili më vonë do të bëhet drejtor i sektorit të etnografisë.

Duke dashur të fshihen nga gjerimanët më 1943 futen në Shkodër, ku jetuan deri më 1948.

Në qytetin e Shkodrës, e cila ish një nga qendrat më të njohura të kulturës dhe shkencës shqiptare e ballkanike, ka banuar në shtëpinë e Vlash Dedit, i cili ishte zdruckthëtar. Banesa ish afër kishës së madhe në lagjen e Tre Heronjve.

Në vitet 1946-1947 ajo jepte vizatim në Shtëpinë e Kulturës, ku ka pasur nxënës piktorët e njohur: Danish Jukniu (i cili më vonë studioi në Poloni), Jakup Keraj (i cili studioi në Rusi) dhe Angjelin Dodmasei.

Në vitin 1948, Aleks Buda, Kryetari i Institutit të sapothemeluar të Shkencave, i tërheq në Tiranë Puzanovët.

Viktoria themelon sektorin e Artit Mesjetar, kurse Vasili punon në Muzeun e Shkencave të Natyrës. Në prill të 49-ës Vasili figuron

si teknik ballsamosës në Institutin e Shkencave.

V. Puzanova boton 8 studime (i fundit botohet mbas vdekjes, aty është bashkautore me Dhorka Dhamon)<sup>3</sup>. Studimi i parë botohet në vitin 1953. Ky është studimi i parë shkencor që botohet në një revistë të specializuar në Shqipëri apo jashtë saj, mbi artin bizantin shqiptar.

<sup>1</sup> Lord Bajron./ J.C.Hobhouse-1809/ M.Leak/ J.V.Hahn-1852/ K.T.Reinhold/ H.Hecquard-1857/ H.Pedersen-1893/ E.Lear/ F.Pouqueville/ T.S.Hughes/ Ippen/ R.A.Davenport/ P.O.Brondsted/ F.Nopcsa/ Topmaschen/ K.Jirecek/ L.Thalloszy/ ZH-K. Faverial/ F.Tajani/ K.Roth/ N.Jorga/ M.Durham/ Orlando/ Kristidhi/ Palikanidhi/ A.Balducci-1922/ A.Calmes/ A.Moschetti/ K.Praschniker/ L.Rey/ L.Ugolini/ Schober/ A.Lord/ Z.Valentini/ A.Brandini/ A.Dyselie/ S.Mann/ W.Cimochowski/ H.Desnickaja/ R.Elsie/ etj.

<sup>2</sup> Anthim Aleksudhi, peshkopi i shumëditur i Beratit, në librin e tij për Beratit, botuar më 1868, flet për tri ikona të shkëlqyera: një Jisu Krishti, një Shën Maria Hyjllindësja, një Joan Pagëzori. Ky autor përmend dhe kishat e Shelcanit dhe Valshit. Po aty tregon se më 1853 i mbuluan me gëlqere afresket e kishës së Shën Marisë së Apollonisë. Ai jep vetëm fakte dhe konsiderata të përgjithshme.

Battifol P. Les manuscrits grecs de Berat d'Albanie et le Codex Purpureus, 1886.

Ilo M. Qafzezi- Jeta Kristiane- 1941,1942- TOMORI 1940.

Lena- Fjala e Korçës 1944.

Dh. Beduli - Të dhëna për kishat në Shqipëri - Dorëshkrim

<sup>3</sup> PUZANOVA VIKTORI - Piktori shqiptar i shekullit të XVI-të Onufri nga Neokastra (Elbasan) - Buletini për Shkencat Shoqërore - 1953. Nr. 3. faqe 2-22.

PUZANOVA VIKTORI - Mbi punimet e piktorit, Nikollës, në kishën Vllaherna (Në kështjellën e Beratit) - Buletini për Shkencat Shoqërore - 1957. Nr. 1. faqe 64-72.

PUZANOVA VIKTORI - Prapë përmbi artin shqiptar të shekullit të XVII-të.

Buletini për Shkencat Shoqërore 1958 - Nr. 2, faqe 152-156.

PUZANOVA VIKTORI - Manastiri "Shën Maria e Apollonisë" në Pojan.

Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës - Seria Shkenca Shoqërore - 1961 - Nr. 3. faqe 147-154.

PUZANOVA. VIKTORI dhe DHAMO. DHORKA - Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë shekujve XII-XV. Studime Historike. - 1967 - Nr. 2 - faqe 105-112.

*Qendra Orthodhokse Diagnostike "Ungjillëzimi", Tiranë*

### Kërkohet një mjek stomatolog

Qendra Orthodhokse Diagnostike "Ungjillëzimi", Tiranë, kërkon të punësojë një mjek stomatolog për Njësinë e Lëvizshme Dentare.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në degën e Stomatologjisë, së bashku me dëshminë e specializimit.

- Të ketë përvojë pune.

- Kandidati duhet të jetë djalë, mundësisht i lirë, pasi do të punojë në të gjithë Shqipërinë.

- Paga është e kënaqshme së bashku me siguracionin.

*Të interesuarit duhet të paraqiten çdo ditë pranë Qendrës Orthodhokse Diagnostike "Ungjillëzimi". Tel. 04 374 804*

*Nga ora 09:00-13:00*

*Adresa: Q.O.D.I, Rr. E Dibrës 159, pranë Medresesë*

Kishin kaluar katër vjet nga koha kur Puzanova kish ardhur në Institutin e Shkencave.

Në këto vite ajo kish bërë disa ekspedita në Valsh dhe Shelcan, në Pojan dhe Zvërnec, në Bregdet dhe Mesopotam, Berat dhe Voskopojë, ku mori pjesë edhe profesori bullgar G. Bogdanov. Ajo tanimë ka filluar të bëjë kopjet e afreskeve të Onufrit.

(vijon në numrin e ardhshëm)

### Kalendari i Liturgjive Hyjnore, NËNTOR 2005

1 E Martë + Anargjendët Kozma e Damian. Dësh. i ri Jakovi. Osh. Davidi.  
5 E Shtunë + Dësh. Galaktioni, Epistima. Ap. Ermai, Lini, etj. nga të 70.

**6 E DIEL + 7 LLUKAIT.**  
Omol. Pavli i Kon/pojës. Omol. Leonardi.

8 E Martë + Kryeengjëjt Mihail e Gavriil dhe Fuqitë e Patrup.

11 E Premte + Dëshm. Minai, Viktori, Vicenti, Stefanidha. Osh.

Theodhor Studiti.

12 E shtunë + Joan Përdëllimtari i Aleksandrisë. Osh. Nili. Osh. Nil Mirovliti.

**13 E DIEL + 8 LLUKAIT.**

Joan Gojarti i Kon/pojës. Oshd. i ri Damaskini.

15 E Martë Dësh. Guria, Samonai, Avivi.

Kuintiani i Seleucisë. (*Fillon Kreshma.*)

16 E Mërkurë + \* Ap. dhe Ungjillor Mateu.

Dëshg. Ifigjenia.

19 E Shtunë + Pr. Abdiu. Dësh. Varlaami, Iliodhori. Azi dhe 150 ushtarët.

**20 E DIEL + 9 LLUKAIT.**

Osh. Grigor dekapoliti. Prokli i Kon/pojës.

**21 E Hënë + Hyrja në tempull e Hyjllindësës Mari.** Osh. Sozomeni.

25 E Premte + Dëshmg. Ekaterina. Dëshm.

Mërkuri. Osh. Porfiri.

26 E Shtunë + Osh. Alipi, Stilian, Nikoni. Jakov eremiti. Dësh. i ri Gjergji.

**27 E Diel + 13 LLUKAIT.**

Dëshm. Jakov persiani. Theodhosi i Tërnovës.

30 E Mërkurë + \* Ap. Andrea, i parëthirruri.

Frumenti i Etiopisë.



**Promovohet libri**  
**“Ngjallja” - Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë,**  
**1991-2003”**

## Me dashuri të thellë për Zotin dhe shqiptarët

(vijon nga faqja 1)

North Western në Minneapolis, SHBA. Ajo ka gjithashtu edhe dy master-a, një për arte dhe një për studime ndërkulturore. Autorja, nga viti 1998 shërben pranë Kishës sonë, si bashkëpunëtore në fushën e botimeve dhe të kujdesit për rininë dhe fëmijët. Për një periudhë 7-vjeçare ajo ka përjetuar nga afër shumë prej arritjeve të Kishës sonë. (Libri kushton 2 mijë lekë)

Në këtë aktivitet, që zhvillohej në seksionin e Artit Bizantin të Galerisë së Arteve kishin ardhur për të nderuar autoren Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas, Mitropoli i Korçës, Hirësia e Tij, Joani dhe Drejtori i Akademisë, Imzot Ilia.

Në fjalën e tij, Hirësia Ilia i bëri një përshkrim përmbledhës librit, duke u ndalur dhe komentuar pjesë të veçanta të tij. “Shihni me vëmendje fotot, - theksoi ai, - e përpiquuni të kujtoni historinë e pashkruar, historinë trime, kurajoze dhe të guximshme që përshkruan njeriun e Kishës, i cili erdhi në Shqipëri me besimin në Krishtin dhe i armatosur vetëm me të vërtetën e Ungjillit të Tij. Lynette Hoppe na ka lënë një trashëgimi, një kronologji në fjalë dhe fotografi të ngjalljes së Kishës Orthodhokse të Shqipërisë dhe ne i jemi përjetësisht mirënjohës. Ky botim i shërben çdo shtëpie dhe çdo biblioteke si një burim real i historisë dhe i ikonës së Kishës së ringjallur plot jetë dhe që akoma lufton për lavdinë e Perëndisë”.


Në vazhdim e mori fjalën vetë autorja e librit, znj. Lynette Hoppe.

Më pas Hirësia e Tij Joani tha ndër të tjera: “Gjatë përgatitjes së këtij libri është derdhur një energji e jashtëzakonshme. Protagonisti kryesor është Lineta, e cila ka punuar për të me shumë dashuri dhe do të doja ta falënderoja në veçanti. Jo më kot libri është quajtur “Ngjallja”, pikërisht sepse ai paraqet ngjalljen e Kishës Orthodhokse. Do të doja t’ju kujtoja që të vinit re se sa punë e madhe është bërë sa që ishte shumë e vështirë

t’i paraqisje në këtë album të gjitha. Në një farë mënyre autori i këtij libri është Kryepiskopi, sepse ai ishte ideatori, udhëzuesi, këshilluesi dhe protagonist i bërjes së veprës si dhe personazhi kryesor i ringjalljes së Kishës në Shqipëri. Doja të falënderoja edhe qindra njerëz të tjerë, që në mënyrë direkte apo indirekte kanë ndihmuar për përgatitjen e librit, pasi ka qenë produkt i një pune grup, por koordinatori i këtij grupi ka qenë vetë Lineta. I urojmë asaj shëndet, fat e lumturi”.

Në fund, Kryepiskopi Anastas do ta cilësonte librin: “Një shenjë, një kandil bese, shprese e dashurie, i mbushur me bukuri, ndjeshmëri dhe saktësi për të vërtetën. Unë ndihem ngushtë, sepse këtu u fol për mua, por personi qendror është Lineta. Ajo mblodhi me shumë dashuri, njohje dhe delikatesë këtë material që paraqet. Prandaj i detyrohem me falënderime me gjithë shpirt. Këto faqe nuk janë për një ose dy persona, por i takojnë mbarë komunitetit orthodhoks që jetoj me shpresën dhe gëzimin e ngjalljes, duke mbajtur gjithmonë këtë qiri të Pashkës dhe duke thirrur “Krishti u Ngjall!”. Por e rëndësishme është se ky libër nuk është vetëm për ne, ai është një dritare që hapet për botën dhe tregon pikërisht se ajo që u bë këto vite këtu, u bë me pjesëma-

Është shumë e vështirë që të kuptohen dimensionet e këtij fakti, që këtu të vijnë njerëz që nuk kanë lidhje me këtë vend, por vetëm sepse i besojnë Zotit dhe e duan Atë. Ata vijnë për të dhënë gjënë më të çmuar që ata kanë: një pjesë të zemrës së tyre, të krijimtarisë së tyre dhe kohën e tyre të vyer, me shumë sakrificë dhe pa menduar për vetveten. Ky është një mesazh për Shqipërinë që nuk duhet të harrohet.



rrijen e mbarë orthodhoksëve, me dashurinë e mirëkuptimin e njerëzve që bëjnë pjesë në komunitetet e tjera fetare dhe ka një kuptim më të thellë jo vetëm për Shqipërinë e Ballkanin, por edhe për botën më gjerë. Libri është shumë i rëndësishëm edhe për brezin e ri, sepse duhet ta marrë ai pishtarin dhe të vazhdojë vrapimin. Rruga jonë po mbaron. Vrapuam në kilometrat e parë, por ju duhe të bëheni gati për të rendur më tej. E keni parë, se këtë pishtar e mbajtën shumë njerëz që nuk lindën në këtë vend, megjithatë ata e deshën me gjithë shpirt.

**Nga fjala e autores znj. Linette Hoppe**

### “Këto vite unë jam rritur bashkë me librin”

Pasi shfaq gjëzimin e të qenit përsëri në Shqipëri, vendin që ajo e ka dashuruar për këto shtatë vjet , ku ajo ka shërbyer si bashkëpunëtore e Kishës, vijoi: “Kur Kryepiskopi më kërkoi që të përgatisja diçka për botim që të përdorej si dhuratë për vizitorët dhe mbështetësit që ishin të interesuar të dinin diçka për punën e madhe që është bërë këtu në Shqipëri, duhet të pranoj që u stepa pak. Atëherë dija pak për Shqipërinë dhe sa kisha nisur të mësoja për veprimtarinë e Kishës Orthodhokse. Gjithë këto vite unë jam rritur me librin. Gjatë këtyre viteve energjia dhe vizioni i mrekullueshëm i Kryepiskopit e ka zgjeruar veprimtarinë e Kishës e së bashku u rrit edhe libri... Kryepiskopi është një njeri me dashuri të thellë për Zotin dhe për shqiptarët. Dua ta falënderoj Fortlumturinë e Tij, që ma besoi mua përfundimin e kësaj veprë, si edhe bashkëpunëtorët e mi që më ndihmuan. Dua të falënderoj edhe Zotin që më dha forcën edhe energjinë për ta mbaruar librin”.

Një shembull i gjallë është pikërisht Lynette Hoppe. Është shumë e vështirë që të kuptohen dimensionet e këtij fakti, që këtu të vijnë njerëz që nuk kanë lidhje me këtë vend, por vetëm sepse i besojnë Zotit dhe e duan Atë. Ata vijnë për të dhënë gjënë më të çmuar që ata kanë: një pjesë të zemrës së tyre, të krijimtarisë së tyre dhe kohën e tyre të vyer, me shumë sakrificë e pa menduar për vetveten. Ky është një mesazh për Shqipërinë që nuk duhet të harrohet... I uroj Linetës dhe Natanit që Zoti t’iu falë shumë shëndet, fuqi, frymëzim e t’i shenjtojnë brenda këtij marshimi që ata kanë ndërmarrë”.

Në vazhdim u organizua një koktej. Nën atmosferën e tingujve të orkestrinës së Radios “Ngjallja”, autorja si kujtim dha nga një autograf për kopjet e librit. Për të gjithë ata që e njohin, Lineta është artistja në arsim dhe në shpirt që gjatë viteve të qëndrimit të saj në Shqipëri ka dhënë shembullin e një njeriu që krishterimin e jeton dhe e rrezaton çdo çast. Me bisedat e saj të ngrohta, me sjelljen delikate dhe buzëqeshjen e saj të ëmbël, që s’do t’i hiqet asnjëherë nga fytyra e ndritshme ajo dëshmon besimin e patundur, forcën, dashurinë e kurajën e saj për jetën.

Aleks Çuri